



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE", VLORE

VENDIM

Nr. 16, Dt. 21.05.2010

Per çfuqizim, te vendimit nr. 1, date 04.02.2010 te KBU "Vjose"

Ne zbatim te vendimit nr.1, dt. 13.01.2010 te K.K.U-se "Per ndalimin e perkohshem te dhenies te lejeve te reja per shfrytezimin e zhavorreve ne shtreterit e lumenjve", si dhe shkreses te deguar nga Ministri Fatmir Mediu, Nr. 1871 Prot, dt. 29.04.2010, "Per zbatimin e vendimit nr.1, dt. 13.01.2010 te K.K.U-se, dhe shkreses nr. 1196 prot, dt. 30.03.2010, po te derguar nga Ministri Fatmir Mediu "Per anullimin e 2 vendimeve te dhena nga K.B.U "Vjose" ne mbledhjen e dt. 04.02.2010, per dhenie te leja te reja per shfrytezim te zhavorreve ne shtraterit e lumenjve, A.U.B Vjose ka paraqitur projekt vendimin e meposhtem.

Duke qene se subjekti "Derveni" sh.p.k, ka paraqitur studim dhe ka kerkuar te pajiset me leje ne nje periudhe e cila perkon pas daljes se vendimit nr.1, dt. 13.01.2010, duke qene se dhe ne relacionin e paraqitur per projekt vendimin nr.1, dt. 04.02.2010, si dhe ne vete projekt-vendimin e zbardhur per miratim te lejes, leja i jepet me kusht subjektit "Derveni" sh.p.k, deri ne nje urdher te dyte, qe lejon dhenin e lejeve te reja per shfrytezimin e materialeve inerte ne shtreterit e lumenjve ne zbatimin e shkreses te siper permendur te Ministrit Fatmir Mediu, K.B.U "Vjose",

VENDOSI:

- 1- Te çfuqizohet vendimi Nr.1, dt.04.02.2010 dhene nga K.B.U "Vjose" per zonen qe parashikohej ti jepej ne perdorim subjektit "Derveni" shpk, ne lumin Vjose ne nje mjedis teresisht lumor, ne afersi te vendbashkimit te perroit te Damasit me lumin Vjose, Qarku Gjirokaster.
- 2- Ngarkohet A.U.B "Vjose" per zbatimin e ketij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

PERGJEGJES I A.U.B "VJOSE"

Ardian DINE



KRYETAR I K.B.U "VJOSE"

Hasan HALILI

